



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 27.06.2023

RAPORT PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2022 DHE MIRATIMIN E PROJEKTREZOLUTËS PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2023

Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e zhvilluara në datat 7 dhe 27 Qershor 2023, mori në shqyrtim raportin vjetor të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022 si dhe projekt – rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022”.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 204, pika 1, germa “d”, të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, ka paraqitur raportin vjetor për punën e tij për vitin 2022, pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Në mbledhjen e datës 7.06.2023, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, organizoi një seancë dëgjimore me z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Veprimtaria e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2022 rezulton me një volum të konsiderueshëm pune, hetimesh disiplinore e masash në përputhje me përgjegjësitë ligjore për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve, fillimin e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve si dhe zhvillimin e inspektimeve tematike.

Raporti vjetor, pasqyron në mënyrë të detajuar të gjithë aktivitetin e institucionit, arritjet dhe problematikat e konstatuara, analizën e punës për vitin 2022 dhe objektivat për vitin 2023.

Përmbledhja e Raportit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022, u prezantua nga, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani.

Gjatë trajtimit të raportit mbi ecurinë e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin kalendarik 2022, zoti Metani theksoi se verifikimi i ankesave, hetimi disiplinor dhe inspektimet kanë qenë në fokus të punës, konkretisht ulja e backlog-ut dhe inspektimet tematike.

Zoti Metani sqaroi se pavarësisht kapaciteteve të paplota të inspektimit, 2 inspektime tematike kanë përfunduar gjatë vitit të raportimit, një i tretë është drejt përfundimit dhe plani i vitit korrent parashikon 4 inspektime të reja në cdo gjykatë e prokurori në vend. Për inspektimet e

përfunduara janë hartuar 16 rekomandime në total, për t'u marrë në konsideratë nga prokuroritë e gjykatat përkatëse.

Gjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare të Shërbimeve të Inspektimit të vendeve të BE- ishte për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë një arritje për vitin objekt raportimi.

Gjatë vitit 2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar të mbajë si prioritet të qëndrueshëm transparencën me publikun, përmes një ndërveprimi me qytetarët, si përmes pasurimit informativ të faqës së internetit të ILD-së ashtu edhe angazhimit të Sektorit të Ndhmës Juridike dhe Ankesave.

Në përmbyllje të trajtimit të raportit zoti Metani parashtroi përpjekjet e kryera nga Institucioni që përfaqëson për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të pavarur si dhe arritjet në nivel të konisderueshëm të rekomandimeve dhe objektivave të ngarkuara për vitin 2022.

Pas përfundimit të prezantimit të raportit vjetor, relatori i çështjes, i caktuar nga komisioni, z. Saimir Hasalla parashtroi mendimin e tij mbi raportin, dhe vlerësoi veprimtarinë e ILD-së gjatë vitit 2022.

Pas prezantimit të raportit, diskutimeve dhe pyetjeve të deputetëve, u konstatuan disa arritje dhe problematika të këtij institucioni, për të cilat u sugjerua që të reflektohen në projekt-rezolutën që do miratohej nga Komisioni për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022.

Në mbledhjen e datës 27 Qershor 2022, në Komision u diskutua dhe për projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022”. Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022”, sipas propozimit të relatorit, duke pasqyruar në versionin final edhe sugjerimet konsultuar me institucionin me qëllim paraqitjen për votim seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Bashkëlidhur teksti integral i Projekt-Rezolutës.

Relator

Saimir Hasalla

KRYETARE

Klotilda BUSHKA